



SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Zyrtar/e i/e lartë për Hulumtime dhe Analiza Ekonomike
Grada: P05
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti: Departamenti i Stabilitetit Financiar, Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike
Divizioni: Divizioni i Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Përpunon dhe analizon të dhëna duke përdorur metoda dhe vegla të avancuara statistikore për të identifikuar trende dhe korrelacione që mbështesin procesin e dizajnit të skenarëve dhe projeksioneve makroekonomike;
- Menaxhon kornizat e brendshme të projeksioneve makroekonomike, përfshirë modelin makroekonometrik, për të mbështetur politik-bërjen në BQK dhe procesin e vendimmarrjes;
- Hulumton dhe propozon mjete, korniza dhe mekanizma për analizimin e të dhënave të sektorëve ekonomik, që mund të përdoren nga departamenti për proceset e punës;
- Definon kërkesat për të dhënat e nevojshme në procesin e hulumtimit dhe analizimit, duke përfshirë mbledhjen, përpilimin dhe organizimin e të dhënave statistikore relevante dhe të sakta nga burime të ndryshme;
- Përgatit raporte dhe prezantime, që pasqyrojnë gjetjet nga analizat ekonomike dhe mbështetë departamentin në rekomandimet përkatëse, me fokus në politik-bërjen makroprudenciale;
- Rekomandon dhe kontribuon në çështje të ndryshme me relevancë për fushën e kërkimeve dhe proceset analitike të punës në departament;
- Mbështet bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante për çështjet e analizave makroekonomike dhe projektimit;
- Përbush detyra tjera në bazë të kërkesës së mbikëqyrësit.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë bachelor në Ekonomi, Financa, Banking, Matematikë Financiare, Studime Kuantitative; preferohet diploma Master në fushat e njëjta.
- Të ketë përvojë pune prej së paku tre (3) vite në fushën e analizave/modelimit/hulumtimeve; Përvoja më e gjatë në fushën relevante përbën avantazh.
- Kërkohej të demonstroj aftësi të shquara të komunikimit verbal dhe me shkrim, dhe prezantimit tek mbikëqyrësi dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip; aftësi në menaxhimin e kohës lidhur me kompletimin dhe cilësinë e detyrave të punës; aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin; aftësi të punuarit, diskutimit dhe bindjes me palët e jashtme;
- Shkathtësi të avancuara statistikore/ekonometrike dhe njohuri të programeve për përpunimin dhe analizim të të dhënave;
- Aftësi të caktimit të prioritetëve të punës dhe të përmbushjes së afateve;
- Njohja e shkëlqyeshme e gjuhës angleze paraqet përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **02 maj 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org